

Informacioni Parakontraktor

INFORMACIONI I STANDARDIZUAR PARAKONTRAKTOR I KREDISË RSF EKSPRES.
ANEKS NR. 1

Emri dhe detajet e kontaktit të bankës			
Banka	Raiffeisen Bank Sh.a		
Adresa	"Rruga e Kavajes", Tirane, Shqiperi		
Numri i telefonit (*)	+355 2 222 669; Call Center +355 4 2 274 910		
Adresa e postës elektronike (*) Numri i faksit (*)	info@raiffeisen.al, ankesa.online@raiffeisen.al, sugjerime@raiffeisen.al		
Adresa e web-it	https://www.raiffeisen.al		
(*) Ky informacion është opsional për Bankën			
Përshkrimi i karakteristikave kryesore të produkteve të kredisë			
Teksti prezantues	Ky dokument nuk përbën një ofertë ligjore detyruese. Shifrat janë dhënë në mirëbesim dhe janë një prezantim i saktë i ofertës që banka do të bëjë sipas kushteve aktuale të tregut, bazuar në informacionin e dhënë. Megjithëkëtë, këto shifra mund të luhaten sipas kushteve të tregut. Dhënia e këtij informacioni nuk parasheh detyrimin e kësaj të fundit për të akorduar kredi.		
Lloji i kredisë	Kredia RSF u jepet të gjithë individëve për të blerë mallra me aprovim të shpejtë pranë njësive tregtare me të cilat Raiffeisen Bank ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi.		
Kanalet e shitjes	Pikat e shitjes (agjentet ne pikat e shitjes), Deget e Bankes dhe Online (vetem per produktet e blera ne dyqanet Neptun)		
Vlera totale e kredisë dhe monedha (Nënkupton shumën totale të disponueshme, të kredisë)	Monedha Leke 500,000		
Nëse është e aplikueshme Kredia është në monedhë të ndryshme nga ajo në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat.	Në monedhë të ndryshme nga të ardhurat e klientit Në të njëjtën monedhë me të ardhurat e klientit		
Nëse është e aplikueshme Vlera e kështit të kredisë, e shprehur në monedhën në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat, mund të ndryshojë.	Ju do të merrni një njoftim në rastet kur, si rezultat i ndryshimit të kursit të këmbimit, kësti i kredisë [i shprehur në monedhën në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat(p.sh. kesti eshte 33,474.84 Lek)] tejkalon vlerën [shtoni shumën në monedhën në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat, e cila është pothuaj 20% më e lartë se kundërvlera e kështit që do të rezultonte nëse do të aplikohet kursi i këmbimit midis monedhës së kredisë dhe monedhës në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat, në datën e nënshkrimit të kontratës (p.sh. 40,169.81 Lek)]. Ju do të keni mundësinë të konvertoni monedhën e kredisë në [monedhën në të cilën gjeneroni të ardhurat],nëse plotësohen kushtet në fuqi të bankës si: - Të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar kështin e kredisë në monedhën e konvertuar - Kursi i këmbimit me të cilin do të realizohet konvertimi i monedhës së kredisë, do të jetë kursi zyrtar i bankës në ditën që kryhet konvertimi - Kushte të tjera në varësi të tipit të produktit dhe rasteve specifike (Nëse është e aplikueshme) Ju do të keni mundësinë të përdorni [shtoni llojet e instrumenteve financiare që banka i ofron konsumatorit për t’u mbrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit] dhe [kushtet]. N/A		
Kushtet që rregullojnë tërheqjen e fondeve (Nënkupton si dhe kur do merren paratë)	Mbas disbursimit të kësaj kredie fondet kalojnë në llogarinë rrjedhëse të Njesisë Tregtare.		
	Shuma e Kredisë	500 000.00	LEK

Këstet dhe, kur është e mundur, mënyra se si do të shlyhen këstet	Totali i Interesave	161 919.28 per kliente pagamarres ne RBAL 224 001.35 per kliente jo-pagamarres ne RBAL	LEK
	Numri i pagesave mujore	48 Muaj per aplikimet ne pikat e shitjes/ dege RBAL 24 Muaj per aplikimet online	
	Komisioni i Administrimit	0	LEK
	Komisioni i Sigurimit	N/A	LEK
	Norma e Interesit	Interesi i Bonove te Thesarit 12 mujore + 11.90% per klientet pagamarres ne RBAL Interesi i Bonove te Thesarit 12 mujore + 16.90% per klientet jo- pagamarres ne RBAL	
Shuma totale që konsumatori do të ketë për të paguar (Nënkupton shumën e fondeve të mundshme për t'u marrë hua, plus interesat dhe kostot e mundshme që lidhen me kredinë)	Shuma totale që klienti do të paguajë për një kredi me shumën 500 000.00 LEK duke përfshirë të gjitha kostot për përfitimin e kësaj kredie është: 661 919.28 Leke per klientet pagamarres ne RBAL dhe 724 001.35 Leke per klientet jo-pagamarres ne RBAL		
Nëse është e aplikueshme Garanci/siguri të nevojshme	SHEMBULL: - Per klientet pagamarres ne RBAL Shuma e kredisë: 500,000 lekë Afat kredie: 48 muaj Interesi per klientet pagamarres: Bono Thesari + 11.9% me NEI 14.5% Kësti i kredisë është 13,789.98 lekë për t'u paguar çdo muaj (përfshin kryegjë + interes). Shuma totale e pagueshme për kredinë ne fund te periudhes është 661,919.28 Leke - Per klientet jo- pagamarres ne RBAL Shuma e kredisë: 500,000 lekë Afat kredie: 48 muaj Interesi per klientet pagamarres: Bono Thesari + 16.9% me NEI 19.5% Kësti i kredisë është 15,083.36 lekë për t'u paguar çdo muaj (përfshin kryegjë + interes). Shuma totale e pagueshme për kredinë ne fund te periudhes është 724,001.35 Lekë		
	Nuk kërkohet kolateral		

Kostoja e kredisë				
Norma e interesit të kredisë që do të aplikohet në kontratën e kredisë	Raiffeisen BANK sh.a., e percakton normën e interesit të kredisë suaj bazuar tek Interesi i Bonove te Thesarit 12 mujore/Euribor (1-vjecar) për Kreditë në ALL/EUR plus një përqindje fikse për gjithë periudhën e kredisë Për cdo vit pasardhës të kredisë, do të rishikohet norma e interesit baze të Interesi i Bonove te Thesarit 12 mujore/Euribor 1-vjecar të publikuar nga Banka për vitin kalendarik, kur paguhet kësti i 12-të.			
	Interes i Bonove te Thesarit/Yield mesatar i ponderuar është norma e titujve te Qeverisë Shqiptare me afat 12 mujor, që rezulton nga ankandi i fundit organizuar nga Banka e Shqipërisë, si ndërmjetëse për shitjen e letrave me vlerë të Qeverisë Shqiptare. Rezultatet nga ankandet e bonove shpallen në të njëjtën ditë të organizimit të ankandit dhe publikohen në faqet respektive të Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqiperisë.			
	EURIBOR është Norma e Interesit Ndërbankar për EURO-n. Kjo normë llogaritet nga Federata Bankare Europiane (FBE) dhe publikohet cdo ditë biznesi në orën 11(ora belge)			
	Normat e Euribor ndryshojne cdo ditë pune bankare dhe mund t’i gjeni të publikuar edhe në sportelet e RBAL.Interesi i Bonove te Thesarit 12-mujore rezulton nga ankandet e zhvilluara, rezultatet e te cilave shpallen ne të njëjtën ditë të organizimit të ankandit dhe publikohen ne faqet respektive te Ministrise se Financave dhe Bankes se Shqiperise			
	Kredimarrësi duhet të paraqitet në bankë për t'u njohur me normën e interesit për periudhën pasardhëse 12-mujore. Në rast se Kredimarrësit nuk bien dakort me ndryshimin e normës së interesit sipas nenit të mësipërm, ata janë të detyruar të informojnë menjëherë mospranimin e këtij ndryshimi. Në këtë rast Kredimarrësit detyrohen të kryejnë ripagimin e plotë të shumës së mbetur të kredisë, duke paguar penaltitetin përkatës që aplikohet në rastet e parapagimit			
	Norma e Interesit për kredinë e interesuar është:	Interesi i Bonove te Thesarit 12 mujore +	11.90%	16.90%
NEI është norma e interesit që përfshin të gjitha kostot e kredisë për të cilën klienti po aplikon.				

Norma efektive e interesit (NEI) <i>Është totali i kostos së kredisë për klientin, e shprehur si përqindje vjetore e vlerës së kredisë së dhënë dhe e llogaritur në përputhje me nenin 6 dhe aneksin nr. 1 të rregullores nr. 59 “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare”.</i>	Norma Efektive e Interesit për kredinë e interesuar është	14.5% per pagamarresit ne RBAL
		19.5% per jo-pagamarres ne RBAL
	<i>Shembull: NEI është 14.5% për kredinë me kushtet specifikuar më poshtë: Shuma 200,000 LEK; Numri i pagesave mujore 36; Komisioni i administrimit i cili do të paguhet njëherë = 0 LEK; Interesi 11.9%+Interesi i Bonove te Thesarit 12 mujore 2.604%</i>	
A është e mundur të përfitohet kredia sipas kushteve të punës në të cilat tregtohet, duke përfjashtuar: -kontratat e sigurimit për kredinë? <i>Nëse koston e këtyre shërbimeve nuk njihen nga banka, ato nuk do të përfshihen në NEI .</i>	Po, pasi për Kredinë Ekspres nuk kërkohet sigurimi i kredisë.	
Kosto të tjera të lidhura me kredinë <i>Nëse është e aplikueshme</i> Mbajtja e një ose më shumë llogarive është e kërkuar për të regjistruar si transaksionet e pagesave ashtu edhe tërheqjet apo transferimet e fondeve nga njëra llogari në tjetrën.	Nuk aplikohet asnjë kosto tjetër e lidhur me kredinë.	
Çdo kosto shtesë që është e detyrueshme për përfitimin e kredisë <i>Kosto shtesë të pakthyeshme në rastin që aplikohen për marrjen e kredisë, të tilla si: komisioni i aplikimit, komisioni i angazhimit, komisioni i disbursimit etj.</i>	Komisioni i vetem i aplikuar me marrjen e kredise është komisioni i administrimit të kredisë i cili eshte <u>0</u> LEK	
<i>Nëse është e aplikueshme</i> Shuma e kostove për përdorim të caktuar të një pagese (p.sh. një kartë krediti)	Nuk aplikohen kosto të tilla	
<i>Nëse është e aplikueshme</i> Ndonjë kosto tjetër që rrjedh nga kontrata e kredisë	Nuk ka kosto te tjera.	
<i>Nëse është e aplikueshme</i> Kushtet, sipas të cilave koston e sipërpërmendura që kanë të bëjnë me kontratën e kredisë mund të ndryshojnë	Ndryshimi i vetëm që ndodh është ndryshimi i Normës së Interesit si efekt i ndryshimit të segmentit të klientit (nga Pagamarrës në klient jo Pagamarrës apo e anasjelltta) sipas parashikimeve që janë dhënë në kontratën e kredisë.	
<i>Nëse është e aplikueshme</i> Detyrimi për të paguar shpenzimet noteriale.	Klienti nuk ka asnjë detyrim për shpenzime noteriale.	
Kostot në rastin e pagesave me vonesë <i>Mungesa e pagesave të kësteve mund të sjellin pasoja të rënda për konsumatorin dhe e bëjnë procesin e mbajtjes së kredisë më të vështirë.</i>	Në rast se Kredimarrësi nuk paguan në kohë këstin e kredisë, Banka përvec normës së interesit, ka të drejtë të aplikojë penalitet në masën 20 % në vit, i llogaritur mbi detyrimin e këstit të rradhes të pa paguar (principal + interes) për numrin e ditëve në të cilën ai është me vonesë. Përllogaritja e penalitetit: P= K*p*n/360 Ku: P = Penaliteti K = Kesti i rradhes p = % e penalitetit per vonese n = Nr i diteve ne vonese <i>Shembull:</i> Kesti i rradhes eshte 10,500 leke Dite ne vonese 5 dite Penaliteti i paguar = 10,500*20%*5/360 = 29 leke Penalitetet dhe kamatëvonosat, të cilat paguhen nga kredimarrësi, nuk do te tejkalojnë në asnjë rast më shumë se 30% të shumës së detyrimit kontraktor (këstit/kësteve të papaguar të kredisë).	
Aspekte të tjera të rëndësishme ligjore		
E drejta për t’u tërhequr	Klienti ka te drejtë të tërhiqet nga kontrata e kredisë pa ndonjë arsye, brenda 14 ditëve nga nënshkrimi i kontrates së kredisë, vetëm në rastet kur ai, pas plotesimit të kërkesës me shkrim, paguan të plotë shumën e kredisë së përfituar plus interesat e përllogaritura për ditët përkatëse. Ne kete rast banka I rimburson klientit komisionin e administrimit, nese ka.	
Shlyerja (pagesa) e kredisë para afatit të maturimit <i>Konsumatori ka të drejtë të kryejë në çdo kohë, paraafatit të maturimit, shlyerjen e pjesshme ose të plotë të kredisë.</i>	Në rast se klienti do të shlyejë kredinë totale ose të pjesshme para afatit të përcaktuar në kontratë banka ka si penalitet aplikimin e komisioneve për shlyerje të parakohshme. 1% mbi principalin që do të shlyhet para afatit, nëse shlyerja e kredisë bëhet para vitit të fundit të periudhës fikse. 0.5% mbi principalin që do të shlyhet para afatit, nëse shlyerja bëhet gjatë vitit të fundit të periudhës fikse.	
Mundësia e zëvendësimit të sendit/pasurisë (kolateralit).	[Vendosni kushtet e zëvendësimit të sendit/pasurisë (kolateralit)] N/A	

Nëse është e aplikueshme Produkte/shërbime shtesë: (Ky informacion është opsional për bankën) Çdo produkt/shërbim shtesë i ofruar nga banka së bashku me kontratën e kredisë dhe që nuk është përmendur në seksionet e mësipërme.	Informacion mbi produktet/shërbimet shtesë të ofruara nga banka: [Vendosni llojin e produkteve të ofruara] Për shembull: “llogari rrjedhëse e lidhur me kredinë”; “llogari kursimi e lidhur me kredinë; “produkte/forma investimi”, “kontratë sigurimi e lidhur me kredinë” etj. Nëse banka ofron një mjet (llogari) kursimi në paketën e kredisë, duhet të sqarohet norma përkatëse e interesit.
<i>Nëse është e aplikueshme</i> Banka ka të drejtën e kompensimit, në rastin e shlyerjes së kredisë para afatit të maturimit.	Në rastin e shlyerjes së kredisë para afatit të maturimit banka ka të drejtën e kompensimit si më poshtë: Komisioni për ripagim kur norma e interesit është variabël është 0%. Komisioni për ripagim kur norma e interesit është fikse: 1% mbi principalin që do të shlyhet para afatit, nëse shlyerja e kredisë bëhet para vitit të fundit të periudhës fikse. 0.5% mbi principalin që do të shlyhet para afatit, nëse shlyerja bëhet gjatë vitit të fundit të periudhës fikse. 0% mbi principalin që do të shlyhet para afatit, nëse shlyerja bëhet gjatë periudhës variable të kredisë.
Informimi në rast refuzimi të kredisë	Banka informon klientin menjëherë dhe pa komisione nëse aplikimi i tij për kredi është refuzuar duke i vënë në dispozicion dhe arsyet mbi te cilat është bazuar ky refuzim.
Mënyra e njoftimit, si dhe mënyra e marrjes së pëlqimit të konsumatorit, në rast ndryshimesh të kushteve, të cilat sjellin pasoja në bazë të kontratës	Cdo kusht i ndryshuar ne kontrate behet me amendim kontrate dhe me nenshkrimin e ketij dokumenti nga te dy palet si Banka dhe klienti. Asnje ndryshim ne kontrate nuk behet pa pranine e klientit.
Skema e brendshme e ankimimit të konsumatorit kundrejt bankës	Nje ankim mund te depozitohet: 1. Prane njerës prej degeve te Raiffeisen 2. Duke telefonuar ne 04 274910 3. adresa e e-mailit ankesa@raiffeisen.al
Periudha kohore gjatë së cilës Banka ka detyrime që rrjedhin nga informacioni parakontraktor	Ky informacion është i vlefshëm prej 7 ditësh

Konsumatori

(Konfirmon marrjen e informacionit parakontraktor)

(emër mbiemër, nënshkrimi)

Date/Muaj/Vit:

